




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.28, datë: 23.02.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 3/2018), neni 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik si dhe neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b), 78 dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, me qëllim të emërimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Auditimin e Brendshëm të Komunës së Kamenicës

1. Emërohen anëtarët e Komitetit për Auditimin e Brendshëm në Komunën e Kamenicës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Shemsedin Ajvazi, kryesues;
 - 1.2. Afrim Sijarina, anëtar;
 - 1.3. Sherafedin Vranja, anëtar;
 - 1.4. Sherif Thaqi, anëtar; dhe
 - 1.5. Petrit Krasniqi, anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Auditimin e Brendshëm janë të përcaktuara në Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike Nr. 06/L-021 dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik.
3. Komiteti i Auditimit do të ndihmojë udhëheqësin e subjektit të sektorit publik në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, duke ofruar këshilla dhe rekomandime për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik lidhur me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.
4. Komiteti i Auditimit mban së paku katër (4) takime në vit, të thirrura nga kryesuesi i Komitetit, ndërsa takimet janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e anëtarëve. Në takime diskutohen çështjet siç janë përcaktuar në Shtojcën Nr. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik dhe çështjet tjera.

5. Kompensimi i anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohet në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Komiteti i Auditimit ka mandat tre (3) vjeçar, me të drejtë riemërimi, por jo më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm, secila në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, **shfuqizohet** Vendimi Sh.02.Nr.35864, i datës 24.10.2023, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Zyrës së Informimit;
- Njesisë së Auditimit;
- Komitetit për Auditim;
- Drejtorive Komunale;
- Anëtarëve të Komitetit sipas Vendimit Sh.02.Nr.35864, i datës 24.10.2023; dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 03.03.2026

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, si dhe neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës. Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.02.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës

1. Ndryshohet paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, dhe riformulohet si vijon:
2. Paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të anëtarit të Komisionit **z. Selami Klaiqi (DKA)**, caktohet anëtare e Komisionit **znj. Belgizare Kryeziu (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Rogaçicë)**.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
4. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës – MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të internetit të Komunës.

Arsyetim

Me Vendimin Sh.01 Nr.21967, datë 12.08.2025, është formuar Komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, në përbërje të të cilit është emëruar edhe z. Selami Klaiqi, i cili në atë kohë ushtronte detyrën e Drejtorit të Gjimnazit “Ismail Qemali” në Kamenicë.

Ndërkohë, z. Selami Klaiqi është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Duke marrë parasysh se Rregullorja (QRK) Nr. 19/2024 përcakton përbërjen e Komisionit dhe nuk parasheh që Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit të jetë pjesë e këtij komisioni, është e nevojshme që ai të lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit dhe të zëvendësohet në përputhje me dispozitat në fuqi.


Për këtë arsye propozohet ndryshimi i nënparagrafit 2.2 të Vendimit Bazë dhe zëvendësimi i tij me anëtarin e re të Komisionit, me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt dhe të pandërprerë të Komisionit.

***Vendimi i u dërgohet:** Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë Komunale të Arsimit, MAPL-së, QSHQ-Arkivit.*


Kryesuese e Kuvendit Komunal
Arbnore BEQIRAJ FERA
Arbnore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Skupština Opštine Kamenica
Datum: 03.03.2026

Shodno člana 12 stav 2 slovo d) Zakona o Lokalnoj Samoupravi (Br.03/L-040) ("Službeni List Republike Kosova" Br. 28/2008), član 53 stav 3 Zakona o Opštem Upravnom Postupku Br. 05/L-031 ("Službeni List Republike Kosova /Br. 20/21 Juni 2016), član 12 stav 1 Uredbe (MALS-a), o Postupcima za Izradu i Publikacija Opštinskih Akata Br.02/2021, kao i člana 38 Statuta Opštine Kamenica, Š 01, Br.20203 od/datum 21.06.2023, Skupština Opštine Kamenica na sednici održanoj dana: 27.02.2026 usvojila,

ODLUKU

O Izmenama i Dopunama Odluke o formiranju Komisije za izbor direktora i zamenika direktora u obrazovnim ustanovama Opštine Kamenica, Š 01, Br.21967 od/datum 12.08.2025

1. Menja se stav 2, podstav 2.2 Osnovne Odluke, o formiranju Komisije za izbor direktora i zamenika direktora u obrazovnim ustanovama Opštine Kamenica, Š 01 Br.21967 od/datum 12.08.2025 i preformuliše se u sledeće:
2. Stav 2, podstav 2.2 Osnovne Odluke o formiranju Komisije za izbor direktora i zamenika direktora u obrazovnim ustanovama Opštine Kamenica Š 01, Br.21967 od/datum 12.08.2025, menja se i dopunjen kao u sledeće: Umesto člana Komisije **g. Selami Klaiqi (OOO)**, za člana Komisije određena je **g-đa Belgizare Kryeziu (Direktorica Škole "Metush Krasniqi", Rogaçica)**.
3. Ova odluka je sastavni deo Osnovne Odluke, o formiranju Komisije za izbor direktora i zamenika direktora u obrazovnim ustanovama Opštine Kamenica, Š 01, Br.21967 od/datum 12.08.2025.
4. U prilog ovoj Odluci stavljena Osnovna o formiranju Komisije za izbor direktora i zamenika direktora u obrazovnim ustanovama Opštine Kamenica Odluka Š 01, Br.21967 od/datum 12.08.2025.
5. Nakon usvajanja u Skupštini Opštine Kamenica, ova Odluka na snagu stupa 30 dana nakon slanja nadzornom organu – MALS-a i 7 dana nakon objavljivanja na službenoj Oštinskoj stranici.

O b r a z l o ž e n j e


Odlukom Š 01, Br.21967, od/datum 12.08.2025, formirana Komisija za izbor direktora i zamenika direktora u obrazovnim ustanovama Opštine Kamenica, u sastavu čijem imenovan i g. Selami Klaiqi, koji u to vreme obavljao dužnost Direktora Gimnazije "Ismail Qemali" u Kamenici.

U međuvremenu g. Selami Klaiqi je postavljen na dužnost Direktora Opštinskog Odeljenja Obrazovanja. S obzirom da je uredbom (VRK), Br. 19/2024 definisano o sastavu Komisije i ne predviđa da Direktor Opštinskog Odeljenja Obrazovanja bude deo ove komisije, potrebno se osloboditi od člana Komisije i zameni u skladu sa važećim odredbama.

Iz tog razloga predlaže se izmena podstava 2.2 Osnovne Odluke i njegova zamena sa novim članom Komisije, ciljem garancija urednog i neprekidnog funkcionisanja Komisije.

Odluku dostaviti: Kancelariji Predsednika, Skupštinskoj Službi, Kancelariji Informisanja, Kancelariji Prevodenja, Opštinskom Odeljenju Obrazovanja, MALS-a i CGU-e- Arhivi.

Predsedavajuća Skupštine Opštine



Arbnore BEQIRAJFERA





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 03.03.2026

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, dhe në përputhje me Statutin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) me nr. 237/15 i dt. 16.06.2015, si dhe në mbështetje të nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës. Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.02.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e delegatëve të Komunës së Kamenicës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)

Neni 1

Me këtë vendim zgjedhën delegatët që do të përfaqësojnë Komunën e Kamenicës në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), për periudhën mandatarë 2025-2029.

Neni 2

Përfaqësimi i Komunës së Kamenicës në Kuvendin e AKK-së do të bëhet nga këta delegatë:

1. **Kadri Rahimaj** – Kryetar i Komunës
2. **Arbnore Beqiraj Fera** – Kryesuese e Kuvendit Komunal
3. **Berat Dërmaku** – Anëtar i Kuvendit

Neni 3

Delegatët e zgjedhur kanë për detyrë të përfaqësojnë interesat e Komunës së Kamenicës në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të AKK-së, të votojnë në përputhje me interesat e komunës, dhe të raportojnë tek Kuvendi Komunal për vendimet e marra në nivel të Asociacionit.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohet.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimi të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Zyrës së Informimit, MAPL-së, AKK-së si dhe Q.SH.Q-arkivit.


Kryesuesë e Kuvendit Komunal


Arbnoje BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 03.03.2026

Bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja d), neni 14 dhe neni 17 pika c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenit 27 (me theks paragrafët 1 dhe 2) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënin e Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenet 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 27.02.2026

V E N D I M PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK

1. Miratohet Vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik prona e paluajtshme e cila është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si në vijim:
 - 1.1. Pronën e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 139 m², sipas certifikatës pronësore P-71107041-01289-0 të datës 23.02.2026 dhe pjesën e pronës me numër P-71107041-01290-0 me Objekt O-71107041-1-0, në Zonën Kadastrale Kamenicë, të evidentuara si Pronë Shoqërore në Pronësi të N.T.SH. QENDRESA, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovare e Privatizimit, Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj prone është bashkimi i pronës Komunale.
2. Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore lidhur me rregullimin e dokumentacionit teknik, regjistrimin e pronës në librin kadastral si dhe çështje e veprime tjera të nevojshme obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë si dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Parcela e cekur në pikën 1.1 të këtij vendimi të bartet në pronësi të Kuvendit Komunal të Kamenicës

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi iu dërgohet: Kryetarit të Komunës, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), QSHQ-Arkivit.


Kryesuese e Kuvendit Komunal

Arbnore BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Skupština Opštine Kamenica
Datum: 03.03.2026

Na osnovu člana 11, 12 stav 1 i stav 2 slovo d), član 14 i član 17 tačka c) Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 (Službeni List Br.28 Objavljeno 4 juna 2008), člana 27 (sa naglaskom stavova 1 i 2) Zakona za Davanje na Korišćenje i Razmena Opštinske Nepokrente Imovine br.06/L-092, vezano članova 34 i 35 Uredbe (VRK) za Utvrđivanje Postupaka za Davanje na Korišćenje i Razmena Opštinske Nepokretne Imovine br.09/2020, člana 3 stav 3.7, član 5 stav 5.1 slovo h) član 38 Statuta Opštine Kamenica Š 01, Br.20203 od/datum 21.06.2023, Skupština Opštine Kamenica na redovnoj održanoj sednici dana: 27.02.2026 donela sledeće,

ODLUKA ZA PROGLAŠENJE U OPŠTEM JAVNOM INTERESU

1. Usvaja Odluka za proglašenje u opštem javnom interesu nepokretne imovine koja je pod upravom Kosovske Agencije za Privatizaciju, kao u sledećem:
 - 1.1. Nepokretne imovine ukupne površine od 139 m², prema imovinskom uverenju P-71107041-01289-0 od/datum 23.02.2026 i deo imovine sa brojem P-71107041-01290-0 sa Objektom O-71107041-1-0, na Katastarskoj Zoni Kamenica, eidentoavne kao Društvena Svojina u Vlasništvu UTP QENDRESA, koje su pod upravom Kosovske Agencije za Privatizaciju, Cilj proglašenja u opštem javnom interesu ovih imovina je spajanje Opštinske imovine.
2. Ovlašćen je Predsednik Opštine da u okviru važećih zakonskih odredbi preduzme sve potrebne postupke za sprovođenje ove odluke.
3. O sprovođenju dotičnih zakonskih postupaka za regulisanje tehničke dokumentacije, upis imovine u katastarske knjige kao i svako drugo pitanje vezano drugih potrebnih postupaka obavezuje se Odeljenje za Imovinu, Katstar i Geodeziju, Odeljenje Urbanizma i Prostornog Planiranja.
4. O sprovođenju ove odluke stara se Predsednik Opštine i Odeljenje Imovine, Katastra i Geodezije kao i Odeljenje Urbanizma i Prostornog Planiranja.
5. Parcela navedena u tački 1.1 ove odluke se prenosi u svojinstvu Skupštini Opštine Kamenica.
6. Nakon usvajanja u Skupštini Opštine Kamenica, ova Odluka na snagu stupa 30 dana nakon slanja nadzornom organu – MALS-a i 7 dana nakon objavljivanja na službenoj Oštinskoj stranici.

Odluku slati: Predsedniku Opštine, Skupštinskoj Službi, Kancelariji Prevođenja, Kancelariji Informisanja, Odeljenju za Imovinu, Katastar i Geodeziju, Odeljenju Urbanizma i Prostornog Planiranja, Odeljenju Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije, Ministarstvu Administracije Lokalne Uprave, (MALS-a), CGU-e - Arhivi.

Predsedavajuća Skupštine Opštine

Arbnore BEQIRAJ FERA

